

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rokadë ambasadorësh/ Ferit Hoxha ndryshon përfaqësuesit, Meidani në Prishtinë, Malaj në Shkup
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/27/roka-de-ambasadoresh-ferit-hoxha-ndryshon-per-faqesuesit-me-idani-ne-prishtine-malaj-ne-shkup/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 19:03:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 18:59:35 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2ca4dcc511465780a87898cd1c5936de6121937fe3462e737adde10e86ce5c3e
TEKSTI	312ba298d650fc855dcd32aef18c67627d4fd33ed431a8bb053e49b8939f8510
PAMJA	7ded1f02bbb6f4535f021434a59d799eb3ac4f6a6d646d728cfbdfcc6d973312

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	aafdedd3c6b11089c8375bb42eef4011bdd6e69281d9090818f38a387e1af030
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	67690963e34eac89a6c1ba46d066d36b47b728bdbf8bf8d029d400ef1ab927ee
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/aafdedd3c6b11089c8375bb42eef4011bdd6e69281d9090818f38a387e1af030>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Rokadë ambasadorësh/ Ferit Hoxha ndryshon përfaqësuesit, Meidani në Prishtinë, Malaj në Shkup

20:59 : 27/09/2026 në AKTUALITET, POLITIKE, RAJONI



Lexo edhe:

[Sypetriti i financave ballë SPAK-ut](#)[Skandali në tenderin e KQZ: Sekretarja ndërhyri në sistem për të favorizuar kompaninë e vëllait të Ferit Hoxhës](#)

Ferit Hoxha, ministër i Punëve të Jashtme, çon përpara idenë e disa muajve më parë për ndryshimin e dy ambasadorëve tanë nga dy vende fqinjë në rajon, si Shkupi dhe Prishtina.

Një prej anëtarëve në Komisionin Parlamentar për Punët e Jashtme i tha Top gazetarit të Top Channel, **Muhamed Veliu**, se më 9 tetor parashikohen në këtë komision dy dëgjesa, të cilat konsiderohen si rokadë ambasadorësh.

Denion Meidani, aktualisht ambasador në Shkup, do të dëgjohej në këtë komision si i propozuar për të drejtuar diplomacinë shqiptare në Prishtinë.

Ndërsa kolegu i tij, **Petrit Malaj**, i cili prej tre vitesh mban postin e ambasadorit në Kosovë, do të paraqesë në këtë komision platformën se si do të çojë përpara drejtimin e ambasadës sonë në Shkup.

Për momentin mbetet i paqartë relacioni shoqërues i ministrit Ferit Hoxha për këto dy propozime, se përse ai e ka parë të nevojshme këtë rokadë ambasadorësh në Shkup dhe në Prishtinë.

Kujtojmë se zanafilla e këtyre dy ndryshimeve për herë të parë u mësua gjatë muajit maj, kur ambasadori Denion Meidani u vu në krah të protestave të studentëve në Shkup.

Atë kohë pati disa raportime, të cilat sugjerorin se ministri Ferit Hoxha kishte marrë disa ankesa nga partia qeverisëse VMRO dhe aleati i saj shqiptar VLEN për qëndrimet dhe rolin e ambasadorit Meidani në ato protesta.

Por Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme i hodhi poshtë këto pretendime, duke i quajtur tërësisht të pabazuara.

TË GJITHA



Rokadë ambasadorësh/ Ferit Hoxha ndryshon përfaqësuesit, Meidani në Prishtinë, Malaj në Shkup

20:59 : 27/09/2026



"Arrestoni Ramën"/ Mbyllen fjalimet te Kryeministria, protestuesit marshojnë në rrugët e Tiranës

20:54 : 27/09/2026



Asgjë e re nga Edi Rama

20:35 : 27/09/2026



Të pathënat e jetës së Alket Rizait, mes burgjeve të Greqisë dhe arratisjeve spektakolare

20:24 : 27/09/2026



Përfshihet nga flakët banesa në Fier, humb jetën i moshuari

20:07 : 27/09/2026



Dyshohet se abuzoi sek*ualisht me një fëmijë, arrestohet shqiptari në Amerikë /EMRI

19:54 : 27/09/2026



"Edi Rama, Shqipëria të urren"/ Protestuesit nisin marshimin drejt Kryeministrit

19:41 : 27/09/2026

Theksonte në një reagim për mediat se “çdo vendimmarrje për emërimet apo lëvizjet diplomatike bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe se këto procese bazohen në analiza profesionale dhe institucionale, me synim përdorimin sa më efikas të burimeve njerëzore dhe në funksion të prioritetëve të politikës së jashtme të Shqipërisë”.

Këto nuk janë të vetmet dy lëvizje ambasadorësh.

Javën e shkuar, në Komisionin Parlamentar për Punët e Jashtme u zhvillua dëgjesa me ambasadorin tonë në Londër, Uran Ferizi, të cilit i është besuar drejtimi i Misionit të Shqipërisë në OSBE në Vjenë.

Për momentin nuk është vendosur ende se kush do të jetë ambasadori i ri i Shqipërisë në Britaninë e Madhe.

Avokat i të drejtave të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut dhe zë i fuqishëm për çështjet shqiptare në rajon, Denion Meidani e ndërtoi mandatin e tij në Shkup mbi një diplomaci aktive dhe të pranishme. Nga avancimi i projektit One Stop Shop, te shpërndarja e Abetares së Unifikuar dhe qëndrimet e forta diplomatike në momente kur përfaqësimi politik shqiptar mungonte ose ishte i zbehtë, ai kërkoi ta kthente Ambasadën në një pikë konkrete mbështetjeje për shqiptarët.

Veçanërisht domethënëse ishte mbështetja për studentët shqiptarë në kauzën për zhvillimin e provimit të jurisprudencës edhe në gjuhën shqipe, një angazhim i adresuar institucionalisht dhe i vlerësuar publikisht nga vetë përfaqësuesit e studentëve. Një mandat që synoi ta bënte diplomacinë shqiptare më të dukshme, më pranë komunitetit dhe më të angazhuar me çështjet që prekin drejtpërdrejt shqiptarët në Maqedoninë e Veriut. **/TCH**

Etiketa: Denion Meidani Ferit Hoxha Petrit Malaj rrokade ambasadoresh

Lajme të lidhura



Sypetriti i financave ballë SPAK-ut

10:58 : 19/09/2026



Skandali në tenderin e KQZ: Sekretarja ndërhyri në sistem për të favorizuar kompaninë e vëllait të Ferit Hoxhës

12:02 : 18/09/2026



Ministri Malaj i valëvit faturën 40 mln euro gjykatësve pasi ata e paditën në SPAK

19:43 : 10/09/2026



Rama-gjyqtarëve: E kallëzuar kot Petrit Malajn! U konsultua me mua për bllokimin e pagave

13:00 : 10/09/2026



Pusteci, himni dhe Rama si "atdhetar modern"

14:58 : 21/08/2026



Himni shqiptar "harrohet" në Pustec/ Ferit Hoxha 'lan duart': Më vjen keq, por aktivitetin e organizoi një shoqatë

11:33 : 21/08/2026

BOLD NEWS

RETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.